

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6453
E hënë, 1 nëntor 2021
çmimi 0.40

G20-a premton
veprime konkrete për
çështjen e klimës | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de


KOSOVA DHE SERBIA PA NDONJË DATË PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT



Përfaqësuesit e Kosovës dhe ata të Serbisë janë shprehur të gatshëm për vazhdimin e dialogut në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve, por nuk kanë treguar për një datë të saktë se kur do të vazhdojë ky dialog. "Kosova jo vetëm do të vazhdojë të ulet në tryezë, por do të angazhohet në mënyrë aktive në dialog, qëllimi përfundimtar i të cilit duhet të jetë njohja e ndërsjellë", ka thënë presidentja Vjosa Osmani. Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Gabriel Escobar, ka theksuar se bisedimet janë rruga më e mirë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës | FAQE 3

NDËRTIMI I RRUGËVE, NJË DEBAT I PAFUND NË KOSOVË

| FAQE 4-5



**HAXHIU: EKSPERTËT KANË
PARALAJMËRUAR VALË TË
RE TË COVID-19** | FAQE 6

AKTUALE



**USHTARËT E FSK-së KRYEJNË ME
SUKSES NJË KURS NË BRITANI TË
MADHE** F. 6

**LËKUNDJET E TËRMETIT NË DIBËR,
110 BANESA TË DËMTUARA** F. 5

**RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE
NË MAQEDONINË
E VERIUT KALOI QETË** F. 2

EKONOMI



**KRIZA ENERGETIKE
NË EVROPË RREZIKON RRETH
2 000 PAGA NË KOSOVË** F. 8

SPORT



**ULPIANA MUND BALLKANIN,
PRISHTINA DRENICËN** F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

G20-a premton veprime konkrete për çështjen e klimës

ROMË, 31 TETOR - Përmes veprimeve "kuptimplote dhe efektive" udhëheqësit e ekonomive më të pasura të botës janë pajtuar t'i vazhdojnë përpjekjet për ta kufizuar ngrohjen globale. Të shtunën dhe të dielën (30 dhe 31 tetor) grupi G20 zhvilloi një samit në Romë të Italisë. "Ne e pranojmë se frenimi i rritjes së temperaturës globale në 1.5 gradë celsius do të ketë ndikime shumë më të ulëta në ndryshimet klimatike sesa nëse ajo është 2 gradë celsius", thuhet në komunikatën përfundimtare të 31 tetorit. Marrëveshja e Parisit për klimën parashihet që vendet të angazhohen për ta mbajtur rritjen e temperaturës globale në 1.5 gradë celsius krahasuar me periudha para-industriale. Megjithatë, në deklaratë nuk tregohet saktësisht se si do të

arrihet kjo.

Deklarata përfundimtare e samitit të Grupit të 20 (G20) në Romë përfshin një angazhim për ta arritur neutralitetin e emetimeve të karbonit "nga ose rreth mesit të shekullit".

Vendet, megjithatë, janë zotuar ta ndalojnë financimin ndërkombëtar të impianteve të reja të qymyrit deri në fund të këtij viti - një porosi e fuqishme për vendet e varura nga qymyri si Kina, Rusia dhe India.

Por, liderët e G20-s nuk ranë dakord për t'i dhënë fund energjisë së qymyrit në vendet e tyre. Grupi G20, i përbërë nga 19 vende dhe Bashkimi Evropian, përbën 80 % të emetimeve në botë.

Aktivistët e mjedisit kanë shprehur zhgënjimin e tyre për draftet fillestare të komunikatës, duke thënë se ajo nuk ishte mjaft e ashpër.



Kishte shqetësime se arritja e një marrëveshjeje nuk do të ishte e lehtë pasi, midis liderëve që nuk u paraqitën personalisht në samit, është edhe presidenti

i Kinës, Xi Jinping.

Kina është ndotësja më e madhe në botë.

Planeti tani është të paktën 1.1 gradë celsius më i nxehtë se

niveli para-industrial.

Shkencëtarët e klimës duan që ngrohja të kufizohet në 1.5 gradë celsius për ta parandaluar katastrofën klimatike.

Bideni i thotë Erdoganit se të dyja vendet duhet t'i shmangin krizat

WASHINGTON, 31 TETOR - Presidenti amerikan Joe Biden i tha presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan të dielën se vendet e tyre duhet t'i menaxhojnë më mirë mosmarrëveshjet. "Kemi në plan një bisedë të mirë", tha Biden para fillimit të bisedimeve. Gjatë takimit Bideni ka ritheksuar rëndësinë e Turqisë si aleate e NATO-s, si dhe partneritetin e saj të mbrojtjes me ShBA-në, por ka ngritur shqetësime për blerjen e sistemit raketor rus S-400 nga ana e Ankarasë, tha Shtëpia e Bardhë përmes një deklaratë. Presidenti turk, ndërkaq, ka thënë disa herë se vendi i tij planifikon ta blejë sistemin raketor rus pavarësisht prej kundërshtimeve.



ShBA-ja dhe aleatët e shohin armatimin rus si një kërcënim për sistemin e mbrojtjes së NATO-s, mirëpo Turqia thotë se S-400 mund të përdoret në mënyrë të pavarur pa u integruar në sistemet e NATO-s dhe për këtë arsye nuk paraqet rrezik.

Turqia u përjashtua nga një

program i ShBA-së për të blerë avionë luftarakë F-35 dhe zyrtarët turq të mbrojtjes u sanksionuan.

Zyra e Erdoganit tha përmes një deklaratë se takimi u mbajt në një "atmosferë pozitive" në të cilën liderët shprehën "vullnetin e përbashkët për të forcuar dhe përmirësuar më

shumë raportet Turqi - ShBA". Tensionet në mes të Perëndimit dhe Turqisë janë tensionuar këtë muaj pasi presidenti Erdogan urdhëroi shpalljen "non grata" (të padëshiruar) të dhjetë ambasadorëve perëndimorë në Turqi, përfshirë atë amerikan, pasi ata kishin kërkuar lirimin e aktivistit të burgosur Osman Kavalla. Nëse do të ndodhnin dëbimet e ambasadorëve, atëherë ky do të ishte një veprim i pashembullt në raportet në mes të vendeve anëtare të NATO-s. Më pas, Erdogani e tërhoqi kërcënimin dhe tensionet u zbutën. Ai tha se qëllimi i Ankarasë nuk ishte të krijonte një krizë. Mosmarrëveshja nisi kur

ambasadat e Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë, Kanadasë, Danimarkës, Finlandës, Francës, Holandës, Zelandës së Re, Norvegjisë dhe Suedisë lëshuan një deklaratë të përbashkët duke kërkuar lirimin e Kavallës.

Filantropi, Kavalla, 64 vjeç, për katër vjet po mbahet në paraburgim edhe pse ende nuk ka një vendim për dënimin e tij nga gjykata.

Paraburgosja e tij ndodhi pas protestave dhe tentativës për grushtshtet në vitin 2016.

Aleanca midis Shteteve të Bashkuara dhe Turqisë është tensionuar vitet e fundit për shkak të dallimeve politike në Siri, blerjes së raketave ruse të mbrojtjes dhe të drejtave të njeriut.

Raundi i dytë i zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut kaloi qetë

SHKUP, 31 TETOR - Në Maqedoninë e Veriut raundi i dytë i votimeve për zgjedhjen e 44 kryetarëve të komunave është zhvilluar të dielën në atmosferë të qetë dhe pa probleme, bazuar në të dhënat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ).

Në disa vendvotime ka pasur probleme teknike që kryesisht kanë të bëjnë me

votimin me sistemin e ri biometrik - identifikimin e votuesve përmes gjurmëve të gishtave, i njohur si "fingerprint" por, sipas kryetarit të KSHZ-së, Aleksandar Dashtevski, ato janë kapërcyer me kohë.

Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar se procesi zgjedhor në gjithë vendin është zhvilluar në atmosferë të qetë, pa incidente

që do ta prishin procesin e votimit. Sipas Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, të drejtë vote në balotazh kanë pasur 1 353, 990 qytetarë, të cilët këtë të drejtë e kanë realizuar në 2 481 vendvotime. Në raundin e dytë është votuar në 44 komuna nga gjithsej 80 sa ka Maqedonia e Veriut, si dhe për kryetarin e Shkupit, që është njësi e veçantë e pushtetit lokal.



Kosova e Serbia pa ndonjë datë për vazhdimin e dialogut



Përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë janë shprehur të gatshëm për vazhdimin e dialogut në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve, por nuk kanë treguar për një datë të saktë se kur do të vazhdojë ky dialog. “Kosova jo vetëm do të vazhdojë të ulet në tryezë, por do të angazhohet në mënyrë aktive në dialog, qëllimi përfundimtar i të cilit duhet të jetë njohja e ndërsjellë”, ka thënë presidentja Vjosa Osmani. Zëvendësndihmës sekretari i Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Gabriel Escobar ka theksuar se bisedimet janë rruga më e mirë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 31 TETOR- Përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë, mund të takohen nga mesi i muajit nëntor për të vazhduar diskutimet rreth përdorimit të targave të makinave, një nga pikat e marrëveshjes së 30 shtatorit që i dha fund krizës në veriun e Kosovës rreth kësaj çështjeje. Por nuk ka ende ndonjë shenjë për takim të nivelit të lartë politik në procesin e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë kanë deklaruar se janë në komunikim me Brukselin rreth çështjeve të hapura dhe shkëmbimeve në distancë të mospajtimeve midis palëve. Javën e kaluar ekipi përfaqësues i boksit të Kosovës nuk u lejua të hyjë në Serbi për të marrë pjesë në Kampionatin Botëror të Boksit në Beograd, duke nxitur reagim edhe të Bashkimit Evropian. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të premten se çështjet e tilla trajtohen në

Bruksel edhe jashtë takimeve ndërmjet palëve. “Së pari me bllokimin që ua bëri boksierëve tanë Serbia në kufi e shpërfaqti edhe njëherë fytyrën dhe thelbin e saj si shtet për ata që kanë pasur dilema. Natyrisht që të gjitha këto çështje adresohen edhe në Bruksel, këto do të adresohen edhe para se të ketë takim në Bruksel sepse ne jemi vazhdimisht në komunikim me ta përmes letrave që ua dërgojmë dhe takimi do të mund të ndodhte diku në gjysmën e dytë të nëntorit sa i përket përfaqësuesve të dy shteteve tona ndërkaq sa i përket udhëheqësve të dy shteteve tona nuk ka ndonjë datë për këtë gjë por besoj që kjo varet në masë të konsiderueshme prej ndërmjetësuesit apo lehtësuesit që është përfaqësuesi i lartë zotëri Borrell përkatësisht emisarit të tij zotit Lajçak”, tha ai. Presidentja Vjosa Osmani në fjalimin e saj në Këshill të Sigurimi, ka thënë se vendi ynë do ta vazhdojë dialogun. “Kosova jo vetëm do të vazhdojë të ulet në tryezë, por do të angazhohet në mënyrë

aktive në dialog, qëllimi përfundimtar i të cilit duhet të jetë njohja e ndërsjellë. Por, nuk është e mundur: që ky dialog të provojë ta shpëtojë karrierën personale të asnjë politikani në Serbi të përfshirë në proces, ose që dialogu të zbrisë në aventura të rrezikshme që i përkasin shekullit XIX. Nuk është dhe nuk do të jetë kurrë e mundur - siç do të mund të dëshironin homologët tanë që të diskutohet për statusin e Kosovës, i cili është zgjidhur njëherë e përgjithmonë në vitin 2008, me përkrahjen e shumicës nga ju. Dialogu zhvillohet midis dy palësh të barabarta, të cilat duhet të trajtohen të tilla”, ka thënë Osmani. Ajo ka theksuar se më e rëndësishmja, ky dialog duhet t’u shërbejë atyre që janë përfutuesit e fundit: qytetarëve, popujve të të dyja vendeve, duke përmirësuar jetën e tyre dhe duke ndërtuar një të ardhme më të begatë dhe më të sigurt për ta. “Pavarësisht se ka qenë viktimë e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit, Kosova sot vazhdon të jetë një

avokate e fortë për paqen dhe e tillë është përfshirë edhe në dialog me Serbinë”, ka thënë Osmani.

Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, tha ndërkaq se po pret nga Brukseli një përgjigje rreth qëndrimeve të autoriteteve në Prishtinë se nuk do të ketë ndryshim të kushtetutës së Kosovës për hir të themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, që është pjesa më e vështirë e bisedimeve. Beogradi ngulë këmbë që kjo të jetë kryetema e takimeve të ardhshme.

Të enjten që lamë pas zëvendësndihmës sekretari i Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Gabriel Escobar tha se bisedimet janë rruga më e mirë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. “Dialogu është forumi përmes së cilit të dyja palët duhet të punojnë si të barabarta për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre dhe për të normalizuar marrëdhëniet dhe ideale do të ishte që kjo të bëhej përmes njohjes së ndërsjellë”, tha ai. Presidenti serb tha se vendit të tij nuk i duhet njohja e Kosovës, ndërsa theksoi se Shtetet e Bashkuara nuk do ta ndryshojnë qëndrimin e tyre rreth pavarësisë së Kosovës në të cilën tha ai, kanë investuar shumë.

Ai vuri theksin tek siç tha, qëndrimi i Escobarit se palët duhet të zbatojnë tërë ato që kanë nënshkruar në Bruksel. Edhe në Raportin e Progresit për vitin 2021 për Kosovën është folur për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë.

Në këtë raport është bërë thirrje që Kosova të

angazhohet në mënyrë më konstruktive në dialog dhe po ashtu të bëjë përpjekje për implementimin e gjitha marrëveshjeve të kaluara që janë nënshkruar. “Sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, dialogu i ndihmuar nga BE-ja ka vazhduar me takime të nivelit të lartë më 15 qershor dhe 19 korrik të vitit 2021, si dhe tri takime në nivel të kryenegociatorëve. Gjatë kohës së raportimit të dy palët kanë emëruar kryenegociatorë të rinj dhe ekipe të reja negociuese. Kosova duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të bëjë përpjekje thelbësore për implementimin e marrëveshjeve të kaluara dhe të kontribuojë në arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjrisht obliguese të normalizimit me Serbinë. Një marrëveshje e tillë është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Kosova e Serbia të avancojë drejt rrugës evropiane”, thuhet në raport. Gjatë fjalimit të tij Komisioneri i BE-së për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliveri Varhelyi, ka thënë se si Kosova ashtu edhe Serbia duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe objektive për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse të normalizimit. Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve është kusht për afrimin me strukturat e Bashkimit Evropian, një synim që mbështetet nga Shtetet e Bashkuara që kohët e fundit kanë dërguar sinjale më të forta për përfshirje më të madhe në përmbushjen e aspiratave të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrim.



Ndërtimi i rrugëve, një debat i pafund në Kosovë

PRISHTINË, 31 TETOR - Adem Lushajt, ekonomist nga Deçani, i duket e pakuptimtë që qeveria të nisë projekte të reja infrastrukturore siç është rruga Prizren - Tetovë pa u përfunduar rrugët magjistrale të nisura para më shumë se dhjetë vjetësh.

Lushajt thotë se qytetarët e Klinës, Istogut, Pejës, Deçanit, Junikut dhe Gjakovës përballen me transport të vështirë për shkak të rrugëve të dëmtuara dhe mosfinalizimit të projekteve rrugore.

Mungesa e infrastrukturës rrugore moderne për këtë pjesë të Kosovës, sipas tij, shkakton humbje dhe nuk i lejon bizneset që të zhvillohen. “Edhe pse i kanë filluar, kanë mbetur punimet në gjysmë që me të vërtetë janë duke e penguar zhvillimin e komunikacionit të lirë sidomos rruga Gjakovë - Klinë që është për keqardhje të kalohet andej. Njëjtë ka mbetur edhe rruga Prishtinë - Pejë”, shprehet Lushajt. Infrastruktura e dobët, sipas Lushajt, i ka lënë këto komuna pa investime.

“Investimet mund të ndikohen edhe nga këto rrugë sepse edhe më lehtë investitorët interesohen të investojnë në atë pjesë ku janë rrugët e mira, qarkullimi i mirë”, thotë Lushajt.

Rruga Prizren - Tetovë s’e pengon asnjë projekt të brendshëm

Në muajin shtator të këtij viti, në një mbledhje të përbashkët, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë së Veriut nënshkruan disa marrëveshje, në mesin e të cilave edhe marrëveshjen për

ndërtimin e një rruge që lidh Prizrenin me Tetovën.

Ndërtimi i kësaj rruge për të cilën tashmë janë bërë studimet e fizibilitetit pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2024.

Kostoja e projektit që përfshinë edhe një tunel rreth 6 kilometra të gjatë pritet të jetë rreth 150 milionë euro dhe synohet që të ndërtohet kryesisht me fonde nga jashtë, thotë për “Radion Evropa e Lirë” zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi. “Ne do të synojmë që të sigurojmë fonde për komplet projektin dhe nëse aplikojmë bashkë si dy shtete, gjasat i kemi më të mëdha që të sigurojmë fonde, por ne e kemi zhvilluar si projekt të rëndësishëm së veçantë që edhe nëse nuk i sigurojmë komplet fonde, një pjesë të tyre do ta sigurojmë nga buxheti i shtetit”, tha Durmishi.

Durmishi thotë se nuk ka nevojë që të ngrehet asnjë shqetësim në Kosovë pasi ndërtimi i rrugës Prizren - Tetovë nuk e stopon asnjë projekt tjetër infrastrukturor. Ai thotë se qeveria është duke u marrë intensivisht me projektet e nisura më parë meqë, sipas tij, modernizimi i infrastrukturës rrugore është prioriteti i qeverisë. “Ne nuk e kemi ndalur asnjë projekt të rëndësishëm brenda territorit të Kosovës në mënyrë që ta realizojmë projektin Prizren - Tetovë. Ne jemi duke i vazhduar të gjitha kontratat: rrugën për Podujevë, rrugën për Mitrovicë, rrugën për Pejë, aty ne e kemi ndalur procesin e shpronësimit, por s’e kemi ndalur ndërtimin e rrugës”, shprehet Durmishi.

Krahas hapjes së korridoreve të reja, profesori i menaxhimit strategjik, Halim

Gjergjizi, thotë se qeveria duhet t’i shtojë përpjekjet për t’i përfunduar projektet që janë lënë në gjysmë. “Gjithsesi këto rrugë kanë filluar dhe duhet të ndërtohen dhe arsyet pse nuk janë finalizuar janë dobësitë tona menaxhuese. Duhet të insistohet që ato të finalizohen, por jo tash të mbyllemi dhe të presim derisa të tjerët janë hapur, kanë hapur korridore, kanë ndërtuar rrugë moderne”, thotë Gjergjizi.

Gjergjizi ka bërë me dije se projekti për rrugën Prizren - Tetovë ka ekzistuar para viteve ’90, por thotë se nuk është implementuar për shkak të rrethanave politike të kohës.

Ish-ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka shprehur kritika ndaj vendimeve të qeverisë. Ai mendon se fillimisht do të duhej të kryeshin projektet që integrojnë qytetarët dhe bizneset e komunës së Klinës, Istogut, Pejës, Deçanit, Junikut dhe Gjakovës me pjesët e tjera të Kosovës.

Lekaj thotë se heqja dorë nga projekti i autostradës së Dukagjinit është prej gabimeve më të mëdha të kësaj qeverie. “Të ndahen 150 milionë euro për rrugën që dërgon në Tetovë, krejt në rregull këto lidhje, por mendoj se është një nguti derisa i kanë penguar projektet e tjera. Si përfundim imi është që kjo qeveri po dëshiron të ndikojë më tepër në këtë kohë në elektorat sesa në zhvillim të infrastrukturës apo ekonomisë”, thotë Lekaj.

Rruga Prizren - Tetovë fuqizon ekonominë e të dyja vendeve

Por, për dallim prej këtyre dyshimeve që

ngrihen në Kosovë për ndikimin e këtij projekti në Maqedoni të Veriut, mendojnë se rruga Prizren - Tetovë është e një rëndësie të madhe ekonomike.

Eksperti i ekonomisë, Arben Halili, thotë se, përveç aspektit kombëtar, hapja e rrugës Prizren - Tetovë në aspektin ekonomik, mes të tjerash, lehtëson qasjen në tregun shqiptar në Shqipëri. “Do të mundësojë shkëmbimin më të lehtë të mallrave dhe shërbimeve dhe njëkohësisht do të lidhë më tepër vende”, shprehet Halili. Halili thotë se shpreson se Qeveria e Maqedonisë së Veriut të ketë vullnet për realizimin e këtij projekti. “Uroj që rruga Tetovë - Prizren të mos ketë të njëjtin fat si ka pasur rruga Shkup - Prishtinë nga pjesa e Maqedonisë së Veriut, por duke marrë në konsideratë se kemi të bëjmë me një projekt vital, besoj se bashkëpunimi ndërqeveritar do të jetë në nivelin e duhur dhe gjithë kjo të jetë në interes të zhvillimit ekonomik të të dyja vendeve dhe, pse jo, të shërbejë edhe si rrugë transit edhe për vendet e rajonit”, thotë Halili.

Rruga Prizren - Tetovë, sipas planifikimeve, pritet të jetë e gjatë rreth 50 kilometra.

Ky do të jetë një projekt i përbashkët në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Kosova me Maqedoninë e Veriut lidhjen kryesore rrugore e kanë përmes autostradës “Arbën Xhaferi” që lidh Prishtinën me Shkupin. Gjatësia e kësaj autostrade është rreth 60 kilometra dhe për ndërtimin e saj nga buxheti i Kosovës janë shpenzuar më shumë se 600 milionë euro.

Cramon për kishën ortodokse serbe në Deçan: Qeveria duhet t'i përmbahet aktgjykimit të Kushtetueses

PRISHTINË, 31 TETOR - Viola Von Cramon, eurodeputete gjermane dhe raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që ta zbatojë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë. Në një shkrim në llogarinë e saj në "Twitter", duke bashkangjitur një foto, ka thënë se kisha

ortodokse serbe në Kosovë duhet të mbrohet dhe të gëzojë të drejta të plota. "Toleranca dhe respekti i ndërsjellë janë thelbi i shoqërisë shumëetnike. Trashëgimia serbe në Kosovë duhet të mbrohet dhe të gëzojë të drejta të plota. Prandaj i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës që ta zbatojë aktgjykimin e GJK-së, i vonuar

prej kohësh, pasi sundimi i ligjit nënkupton trajtim të barabartë të të gjithëve", ka shkruar Cramon. Ndërkaq, edhe pse vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës janë përfundimtare dhe të detyrueshme për të gjitha palët, udhëheqja lokale në Deçan po refuzon që ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,

sipas të cilit, 24 hektarë tokë i përkasin Manastirit të Deçanit. Autoritetet e atjeshme lokale thonë se ajo pronë u takon ndërmarrjeve shoqërore "Apiko" dhe Iliria" dhe se asnjëherë nuk i ka takuar manastirit. Ata konsiderojnë që Gjykata Kushtetuese e ka legalizuar vendimin e Slobodan

Milloseviqit, të vitit 1997, kur vendosi që atë pronë t'ia dhurojë manastirit.

Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, më herët ka thënë se autoritetet lokale nuk e kanë ndryshuar qëndrimin dhe se vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nuk do të zbatohet.



Lëkundjet e tërmetit në Dibër, 110 banesa të dëmtuara



DIBËR, 31 TETOR - Të dielën është rritur bilanci i dëmeve nga tërmeti në qarkun e Dibrës. Nga verifikimet në terren u konstatuan të dëmtuara 110 banesa, nga të cilat 70-75 banesa të dëmtuara lehtë dhe

30-35 banesa me dëmtime të mesme. Lëkundje të fuqishme të tërmetit pati të premtën me magnitudë 4.5 rihter në Bulqizë. Banorët ndihen të frikësuar dhe kërkojnë strehim në çadra pasi u

druhen lëkundjeve me magnitudë më të lartë. Zamira Jakimi, banore e fshatit Shtushaj, ka thënë se qëndrimi në banesë tashme është i pasigurt, ndaj kërkon ndihmën e autoriteteve të paktën për një

çadër. Për të parë nga afër dëmet e shkaktuara, në terren doli vetë kryebashkiaku i Bulqizës, Lefter Alla. Ky i fundit bëri me dije se dëme janë shënuar pothuajse në të gjitha njësitë

administrative, ku mes tyre veçohet dëmtimi i dy pallateve në Bulqizë dhe dy në Krastë. Duke qenë se Bulqiza është zonë sizmike, banorët po qëndrojnë në ankth nga frika e lëkundjeve më të forta.

Një i vdekur dhe 13 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 31 TETOR - Shëndetësisë Publike i Kosovës ka, njoftuar se nga 20 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 346. Në total numri i rasteve aktive është 439.

19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të dielën janë shëruar edhe

20 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 346. Në total numri i rasteve aktive është 439.



Haxhiu: Ekspertët kanë paralajmëruar valë të re të Covid-19

PRISHTINË, 31 TETOR - Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka thënë se ekspertët kanë paralajmëruar valë të re të Covid-19. "Ekspertët e shëndetësisë paralajmërojnë valë të re të Covid-19 dhe kjo shifër e vaksinimit është e ulët për ta mbrojtur popullatën nga valët e reja të Covid-19", ka thënë Haxhiu.

Ai ka theksuar se Ministrisë së Shëndetësisë i nevojiten tetë muaj kohë për ta filluar procesin e vaksinimit me ekipet mobile në sheshet e Kosovës. Ai ka thënë se papërgjegjësia, paaftësia dhe

neglizhenca e MSh-së në procesin e vaksinimit rezultoi me humbjen e jetëve të shumë qytetarëve. "Me vetëm 40 për qind të qytetarëve të vaksinuar me dy dozat e vaksinës kundër Covidit Ministria e Shëndetësisë e ndërpret sërish vaksinimin gjatë vikendeve, duke e lënë anash edhe fushatën për vaksinim dhe, për pasojë, kemi rënie të numrit të të vaksinuarave në baza ditore e javore. Dikush duhet të japë llogari për katastrofën shëndetësore të shkaktuar gjatë muajve të kaluar për jetët e

humbura nga Covid-19, pa llogaritur këtu pasojat shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuara nga veprimet e papërgjegjshme, politike e populiste të kësaj qeverie. Dikush duhet të japë përgjegjësi për 133 mijë doza të vaksinave të cilave u kaloi afati i përdorimit. Sipas të dhënave të publikuara nga Universiteti 'John Hopkins' në Kosovë për 8 muaj vetëm 40 për qind e qytetarëve janë të vaksinuar me të dyja dozat e vaksinave anti-Covid-19", ka deklaruar deputeti Haxhiu.



Komandanti i KFOR-it: Pa miratimin tim, FSK-ja nuk mund të vendoset në veri



PRISHTINË, 31 TETOR - Komandanti i KFOR-it, Ferenc Kajari, ka folur për situatën aktuale dhe gjendjen e sigurisë në Kosovë. Ai ka theksuar se pa miratimin e tij nuk mund të bëhet vendosja e FSK-së në veri të Kosovës. "Forca e Sigurisë së Kosovës, sipas një marrëveshje të mëparshme, duhet të autorizohet nga komandanti i KFOR-it para çdo

dislokimi në veri të Kosovës. Policia e Kosovës mund të lëvizë lirshëm në mbarë Kosovën. NATO pret që institucionet vendase të vazhdojnë t'u përmbahen marrëveshjeve. Në javët e para jam takuar me krerët e institucioneve në Kosovë, të cilët më kanë siguruar se para çdo veprimi do të ketë koordinim të duhur me Kosovën dhe vendosja

e FSK-së në veri të Kosovës do të vazhdojë të bazohet në njoftimin dhe miratimin paraprak nga komandanti i KFOR-it", ka thënë Kajari në një intervistë për "Kosovo Online". Kajari ka shtuar, po ashtu, se e ka ditur se detyra që po e merr është komplekse, por qysh në fillim është përballur me sfida të ndryshme.

Pastrohet liqeni i Batllavës, apelohej që të mos ndotet uji



PRISHTINË, 31 TETOR - Organizata Sundimi i Demokracisë në Kosovë (SDK) ka organizuar aktivitet për pastrimin përreth liqenit duke vendosur edhe tabela që bartin mesazhe për vetëdijesimin qytetar ndaj ruajtjes së ujit të pijshëm në liqenin e Batllavës. SDK-ja nëpërmjet një komunikate ka theksuar se është e përkushtuar që nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të ndikojë në rritjen e vetëdijesimit qytetarë dhe

njëkohësisht të avokojë tek institucionet për përkujdesjen ndaj ujit në liqenin Batllava. "Një ndër kërkesat e vazhdueshme ka qenë vendosja e shportave në hapësirat përreth liqenit, e që tashmë këto shporta janë vendosur nga komuna e Podujevës. Ndërlidhur me këtë, SDK ka ndërmarrë edhe një aksion të pastrimit përreth liqenit Batllava në Orllan si dhe janë vendosur disa tabela (pllakate) vetëdijesuese. Përmbajtja e

pllakateve ka për qëllim të ndikojë në masën qytetare mbi rëndësinë e ujit të pijshëm dhe kujdesit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ujit. Ky aktivitet është bërë në kuadër të projektit 'Aktivizmi qytetar dhe institucional për përmirësimin e gjendjes për mjedis të shëndetshëm', i cili mbështet financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit", thuhet në komunikatën për media.

Ushtarët e FSK-së kryejnë me sukses një kurs në Britani të Madhe


PRISHTINË, 31 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka bërë me dije se ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë kryer me sukses të plotë "Kursin për vëzhgim dhe zbulim në

operacione luftarake". "Ky kurs është realizuar nga specialistët britanikë dhe specialistët tanë të shkolluar në Divizionin e Taktikave të Blinduara dhe Vëzhgimit në Warminster. Falënderim i

veçantë për Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e madhe në të gjitha aspektet. Forca djema! Vazhdojmë me suksese të reja!", ka shkruar Mehaj në rrjetin social "Facebook".



Kriza energjetike në Evropë rrezikon rreth 2 mijë paga në Kosovë



PRISHTINË, 31 TETOR - Paga e tetorit nuk do t'i mjaftojë Sehat Behramit nga Drenasi as për ta paguar këstin e kredisë. Për më shumë se 30 vjet Behrami ka punuar në korporatën e metalurgjisë "Ferronikeli" që gjendet në Drenas, rreth 30 kilometra larg Prishtinës. "Ferronikeli" ka qenë kompani publike para se të privatizohej në vitin 2005. Në vitin 2018 ajo është blerë nga kompania e Shqipërisë "Balfin Group". Kjo kompani e ndërpreu prodhimin më 8 tetor të vitit 2021 për shkak të shtrenjtimit të energjisë elektrike në Evropë. Kjo mbyllje i la të pasigurt rreth 2 mijë punëtorë të kompanisë. Behrami që punon si pastrues thotë se me pagën që e merrte në "Ferronikel" mban familjen shtatantëtarëshe. Për muajin tetor kjo kompani pritet t'i

paguajë punëtorët me gjysmën e pagave, ndërsa për nëntor nuk dihet se çfarë do të ndodhë. "Veç me shpresa, këto shpresa po na mbajnë sepse tjetër gjë nuk ka ka mbetur. Nëpër kredi jemi dhe çmimet janë ngritur, kanë shkuar në hënë tash!", thotë Behrami.

Ky punëtor së bashku me dhjetëra kolegë të tij, për dy ditë rresht, të mërkurën dhe të enjten, protestuan para Qeverisë së Kosovës për të kërkuar ndihmë. "Nëse qeveria na ndihmon, na shpëton", thotë Behrami.

Kompania "Balfin Group", që është në pronësi të "Ferronikelit" deri në momentin e publikimit të këtij artikulli, nuk u është përgjigjur pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" lidhur me këtë çështje. Për ndërprerjen e punës në

kompani, më 8 tetor kishte njoftuar kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci.

"Edhe ne jemi Kosovë" si dhe "Kompania është privatizuar, por jo edhe ne" ishin disa prej pankartave të punëtorëve protestues para Qeverisë së Kosovës.

Rifat Halimi që të enjten foli para protestuesve tha se ndërprerja e punës në këtë kompani mund të shkaktojë probleme shumë më të mëdha sesa mungesa e përkohshme e pagave.

Nga Qeveria e Kosovës nuk ka pasur reagime lidhur me kërkesën e punëtorëve për ndihmë. Ata nuk u janë përgjigjur as pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" lidhur me këtë çështje deri në momentin e publikimit të këtij artikulli.

Por, protestat nuk pritet të

ndalen.

Sipas kryetarit të Sindikatës së Punëtorëve të "Ferronikel"-it, Fehmi Nika, veprimet sindikale do të vazhdojnë. "Ne kemi bërë protestë paqësore, i kemi bërë thirrje qeverisë që të merret me rastin tonë, por nëse nuk merret, shkojmë në masa të tjera", tha Nika. Sipas Nikës, paga mesatare e punëtorëve në këtë kompani është rreth 550 euro.

Rënia e eksportuesit gjigand prek ekonominë

Fabrika "Ferronikeli" prodhon dhe eksporton nikel nëpër shumë vende të botës, përfshirë Italinë, Indinë, Belgjikën, Britaninë e Madhe dhe vendet skandinave.

Nikeli nga kjo kompani shitet së

bashku me hekur pasi ndarja e këtyre metaleve nuk ka mundësi të bëhet brenda fabrikës.

Prodhimi vjetor i fabrikës përfshin mes 7 000 dhe 10 000 tonë të nikelit dhe hekurit. Kujtojmë se sipas të dhënave nga "Tradingeconomics", këtë vit një ton i nikelit kushton 20 mijë dollarë amerikanë apo mbi 17 mijë euro.

Kompania e "Ferronikel"-it është ndër eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë.

Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, vetëm në vitin 2019 kjo kompani kishte eksportuar nikel në vlerë prej 51 milionë eurosh. Nëse krahasohet kjo shumë me eksportin e përgjithshëm nga Kosovë për vitin 2019 që është 383 milionë euro, i bie që "Ferronikel"-i përbën rreth 13 për qind të të gjithë eksportit në vend.

Në anën tjetër, në Kosovë importi për atë vit ka qenë rreth 3.5 miliardë euro vlerë e mallrave. Ish-ministri i energjisë, Fadil Ismajli, mendon se ndërprerja e punës së këtij gjigandi metalurgjik dhe eksportuesi të fuqishëm është shenjë e prekjes së ekonomisë së Kosovës nga kriza energjetike në Evropë.

Kosova, megjithatë, nuk është prekur ende drejtpërdrejt nga kriza energjetike për shkak se furnizimi me rrymë po vazhdon ta mbulojë prodhimi vendor i rrymës.

Arsyeja pse kompania "Ferronikeli" u prek nga kjo rrymë është për faktin se e blen rrymën nga tregjet e jashtme dhe nuk furnizohet nga Kosova.

Rukiqi thotë se rritja ekonomike këtë vit parashihet të jetë 7 për qind

PRISHTINË, 31 TETOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se deri në fund të vitit parashikohet që vendi të ketë rritje ekonomike jo më të vogël se 7 për qind. Ai ka thënë se nëse synohet të arrihet kjo rritje ekonomike duhet të ketë një dinamikë të implementimit të investimeve kapitale. "Ne nëse duam të mbajmë një momentum të rritjes ekonomike atëherë duhet të shihet që të ketë një dinamikë të implementimit të investimeve kapitale për arsye të ndryshme qoftë ato që lidhen me zgjedhjet e shpeshhta, ndryshimit të qeverive dhe pandemisë. Duhet të shikohet mundësi e investimeve edhe në zona

ekonomike dhe, po ashtu, të shikohet mundësi të përkrahen edhe eksportet dhe mund të shumëfishohet edhe vlera e eksportuesve. Kemi projeksione të Fondit Monetar Ndërkombëtar 7 për qind, Bankës Botërore 7.5 për qind, të qeverisë e cila pret rreth një vlerë dyshifrore të rritjes ekonomike", ka thënë ai raporton "EO".

Rukiqi ka thënë se në fund do ta kemi një shifër të rritjes ekonomike që do të jetë një shkallë e rritjes ekonomike dhe, po ashtu, një ndryshim të dukshëm sa i përket rritjes së eksportit. "Projeksionet janë për një rritje ekonomike jo më e vogël se 7 për qind. Ne nuk mund të presim të kemi të njëjtën shkallë të vizitave të



diasporës dhe nuk mund të presim të kemi të njëjtin raport

me shtimin e konsumit. Ky vit mund të shënohet i suksesshëm

sa i përket rritjes ekonomike", ka deklaruar Rukiqi.

Të mësosh nga dështimet, si Thomas Alva Edison

Nuk kam dështuar dy mijë herë në krijimin e një llambe. Thjesht gjeta një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mënyra se si nuk krijohet një llambë

Nuk ka asnjë aspekt të vetëm të jetës moderne që nuk ka ndryshuar falë Thomas Alva Edisonit, gjenit, vizionarit, shpikësit. Nga llamba e dritës që ai perfeksionoi, deri te krijimi i gramafonit, duke kaluar përmes kinetoskopit, pararendësit të projektorit të kinemasë dhe sistemeve të shpërndarjes elektrike.

Një sipërmarrës, një shkencëtar, një njeri me pushtet i destinuar të ishte askushi, sikur të kishte dëgjuar të tjerët, të gjithë ata që vinin bast për dështimet e tij, dhe jo për sukseset. Por ia doli gjithsesi dhe ndryshoi botën, falë edhe edukimit të ngurtë dhe të dashur të nënës së tij, mbështetëse së tij të parë dhe të madhe, të vetmes që besonte tek ai kur mësuesit e tallnin.

E vërteta është se ai fëmijë i keqkuptuar kishte vetëm dëshirën për të eksperimentuar dhe studiuar në mënyrën e tij, duke shkuar përtej mësimit të thjeshtë dhe të kornizuar në shkollë. Nancy Matthews Elliott,

nëna e tij, e kuptoi menjëherë këtë. Dhe ajo i dha fëmijës së vet të gjitha mjetet për të revolucionarizuar botën.

Ja ku ai është 19 vjeç me patentën e tij në dorë, e para nga një seri e gjatë me emrin e tij: 1093 gjithsej. Një regjistruer elektrik për të numëruar votat që gjithsesi rezultoi i dështuar. Një dështim, ky, që do të kishte demoralizuar këdo. Të gjithë, por jo atë.

Menjëherë pas kësaj vjen shpikja e gramafonit, instrumenti i parë në histori i aftë për të regjistruar dhe riprodhuar tinguj. Dhe pastaj llamba. Ishte viti 1879 dhe Edison po revolucionarizonte botën duke sjellë dritë në të. Ai nuk ishte i pari që e shpiku, por ishte i vetmi që arriti të tregtojë produktin dhe ta bëjë atë të aksesueshëm për të gjithë popullatën.

Falë Edisonit, bota dhe gjithçka që u formua prej tij, nuk ka qenë kurrë e njëjtë. Dhe njohja e historisë së saj nuk është e dobishme vetëm për pasurimin e bagazhit personal kulturor, por



është veçanërisht e vërtetë për mësimin e madh që na mëson historia e gjenit.

Thomas Alva Edison ka grumbulluar shumë suksese, por dështimet i kanë tejkualuar këto. Ai imagjinoi, provoi dhe

eksperimentoi dhe më pas e bëri përsëri, derisa ia doli. Ai gjithmonë e ka konsideruar dështimin si një fazë suksesi dhe historia e tij na mëson se kishte të drejtë.

Ai nuk u dekurajua kurrë sepse

në të gjitha gjërat që nuk funksiononin, ai shihte hapa drejt arritjes së qëllimeve të veta. Dhe ky është mësimi më i çmuar, sepse vetëm ata që dështojnë mund të bëhen të mëdhenj. / bota.al

Për sa kohë u shkatërrua Pompei?

Shpërthimi i Vezuivit zgjati mbi 24 orë dhe, sipas një studimi stratigrafik të vitit 1982, bazuar në analizën e shtresave të hirit, u zhvillua në dy faza: e para, ajo që varrosi Pompein, zgjati 20 orë. E dyta pas rreth 12 orësh: drejtimi i erërave ndryshoi dhe Herculaneum dhe qytetet në veriperëndim të vullkanit u goditën.

Qendrat e banuara u shpërndanë përgjatë shpateve dhe afër Vezuivit, që deri disa vite më parë konsideroheshin një mal i zakonshëm (ngjarjet e para të asaj tragjedie filluan në vitin 62 pas Krishtit). Në fakt, vullkani kishte qenë joaktiv (sot do të thoshim i fjetur) për tetë shekuj.

Më 24 tetor 79 A.D. (dhe jo më 24 gusht, siç konfirmohet nga zbulimi i fundit në gërmime, i një mbishkrimi me qymyr që daton në periudhën e vjeshtës) Vezuvi shkaktoi një shpërthim, duke u varrosur nën një shtresë hiri dhe mbeturinash inkandeshente, disa metra të lartë qytetet përreth.

Kolona e hirit (reja piroklastike) u ngrit në qiell një pasdite pas një tronditjeje të fuqishme: duhet të ketë qenë pothuajse 26 kilometra e lartë dhe kur u shemb, goditi zonën përreth me një shpejtësi mbi 100 kilometra në orë, duke

varrosur gjithçka.

Rreth 16-20,000 njerëz jetonin në Pompei dhe Herculaneum: mbetjet e rreth 1,500 njerëzve u gjetën në hirin e gurëzuar, por numri i përgjithshëm i viktimave nuk dihet.

Shpërthimet e Plinit

Shpërthimi u përcaktua si Plinian sepse u vëzhgua nga shkrimtari dhe senatori romak Plini i Riu (rreth 61-114 pas Krishtit) i cili e përshkroi atë në detaje në një letër dërguar mikut dhe historianit Publius Cornelius Tacitus, 30 vjet më vonë.

Në kohën e shpërthimit Plini ishte në Miseno, në gjirin e Napolit, rreth 35 kilometra nga Pompei. Në letër ai shkruante se kishte parë një re shumë të lartë tymi të përzier me hi duke u formuar në qiell. Ai e krahasoi atë me "një pemë pishe" e cila "u ngrit në një lartësi të madhe si një trung i madh nga maja e të cilit u shpërndanë formacionet si degë". Sot ne i përcaktojmë shpërthimet e prodhuara nga vullkanet si Vezuvi si pliniane: këto vullkane lëshojnë një lavë shumë viskoze që grumbullohet në majë, duke parandaluar daljen e gazrave.



Me kalimin e kohës, kjo çon në një rritje të presionit të brendshëm deri në lëshimin e menjëhershëm, i cili manifestohet në shpërthimin e pjesshëm ose total (në rastet më të rënda) të vetë vullkanit. Kur ndodh, një kolonë e madhe hiri, lapili dhe gazi (kolona shpërthyes) ngrihet për dhjetëra kilometra dhe më pas shembet duke rënë në tokë me efekte shkatërruese, siç ishte për Pompein dhe Herculaneumin.

Pyetja e datës

Për një kohë të gjatë mendohej se shpërthimi i Vezuivit ndodhi më 24 gusht 79 pas Krishtit, një datë e nxjerrë nga letra e lartpërmendur nga Plini drejtuar Tacitit, e cila i referohet nonum cal. shtator, pra nëntë ditë përpara kalendareve të shtatorit, datë që i korrespondon 24 gushtit.

Megjithatë, disa arkeologë e kanë rishikuar së fundmi këtë hipotezë.

Për të sugjeruar se shpërthimi mund të ketë ndodhur më vonë ishte zbulimi në vendin arkeologjik të Pompeit i një monedhe që i referohet shpalljes së pesëmbëdhjetë të Titit si perandor, e cila ndodhi pas 8 shtatorit 79, si dhe fruta të thata dhe mangalla të përdorura zakonisht për dhomat e ngrohjes. Kjo do të sugjeronte se shpërthimi mund të ketë ndodhur dy muaj më vonë, ndoshta më 24 tetor 79 pas Krishtit. / bota.al



'Sindroma e Havanës', një akt lufte apo një histeri masive?

Nga Spenser BOKAT-
LINDELL

Në fundin e vitit 2016 dhe fillimin të vitit 2017, 21 diplomatë amerikanë në Kubë nisën të përpjetojnë simptoma neurologjike serioze dhe në disa raste dobësuese, pa asnjë shpjegim të dukshëm, duke përfshirë dhimbjet e kokës, të vjellat dhe humbjen e dëgjimit, të shkaktuara, raportuan shumica e tyre, nga një tingull i mprehtë, si të ishin goditur nga një "rreze epadukshme energjie". Shtëpia e Bardhë u bind shumë shpejt, se ato simptoma ishin rezultat i "sulmeve specifike": Administrata Trump reagoi duke dëbuar 15 diplomatë kubanë nga Uashingtoni, dhe duke tërhequr shumicën e stafit të saj nga ambasada në Havanë.

Pesë vjet më vonë, më shumë se 200 zyrtarë të qeverisë amerikane në vende të ndryshme në botë, kanë pretenduar se janë prekur nga ajo që tani njihet si "Sindroma e Havanës". Raportet për një seri rastesh të ngjashme misterioze në Hanoi të Vietnam, vonuan me disa orë vizitën e zëvendës-presidentes amerikane Kamala Harris në gushtin e këtij viti.

Në shtator, presidenti Biden nënshkroi një ligj për kompensimin financiar të viktimave. Megjithatë shkaku

mbetet i mbuluar me mister, spekulime dhe dyshime. Teoria kryesore në mesin e zyrtarëve të inteligjencës amerikane, ia atribuon sëmundjen jo vetëm "sulmeve specifike", por edhe atyre të ekzekutuara përmes armëve sekrete me mikrovalë, të përdorura nga agjentët e fuqive të huaja armiqësore, dhe sidomos nga Rusia.

Nëse kjo çështje ju tingëllon si një temë nga një film me Xhejms Bondin, atëherë nuk jeni vetëm. Një nga arsytet pse dezinformimi është kaq i vështirë për t'u ç'rrenjosur nga vetëdija publike, është se ky është një proces i lodhshëm.

Në vitin 2018, revista e njohur e Shoqatës Mjekësore Amerikane, publikoi një studim mbi 21 diplomatët, të udhëhequr nga Daglas H. Smith, drejtori i Qendrës për Dëmtimin dhe Riparimin e trurit në Universitetin e Pensilvanisë. Smith dhe ekipi i tij, thanë se gjetën shenja të dëmtimit të trurit, por asnjë shenjë goditjeje në kafkën e pacientëve.

"Në fillim të gjithë ishim relativisht skeptikë. Por tani të gjithë janë dakord se diçka ka ndodhur" - thekson Smith. Në fillim zyrtarët e qeverisë amerikane, sugjeruan se kjo "diçka" ishte shkakuar nga një lloj arme zanore. Por kjo teori ka qenë pak a shumë e diskredituar. "Unë nuk njoh asnjë efekt akustik, që mund të

shkaktojë simptoma të tilla" - thotë për "The New York Times" Jurgen Altman, fizikant dhe ekspert i akustikës.

"Një tingull që kalon nëpër ajër nuk mund të tronditë kokën tuaj" - shton ai. Për më tepër, tingujt në regjistrimet e armës së supozuar, u identifikuan më vonë nga biologët si kënga e një specie jashtëzakonisht të zhurmshme, siç është bulkthi. Në dhjetorin e vitit 2020, Akademia Kombëtare e Shkencave, ofroi një shpjegim alternativ, që ia atribuonte sëmundjen jo zërit, por dritës, në formën e mikrovalëve. Përkrahësit e kësaj teorie flasin për të që njihet si Efekti Fraj. Në fillim të viteve 1960, neuroshkencëtar Alan H. Fraj, vërtetoi se mikrovalët mund ta mashtrorin trurin për të "dëgjuar" tinguj që nuk ekzistojnë në realitet.

Ai zbulim që çoi në një lloj gare armatimi midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara, për krijimin e armës me mikrovalë. "Është e besueshme, që nëse ka gjatësinë e duhur të valës, një rreze elektromagnetike mund të projektohet mbi qindra metra larg, për të krijuar simptomat që përshkruhen në rastet e Sindromës së Havanës.

Nëse është vërtet kështu, ka të ngjarë që këto rreze të ndërhyjnë në funksionet elektrike të trurit dhe sistemit nervor qendror" -

shkruan Jan Boid, profesor i inxhinierisë së hapësirës ajrore. Megjithatë, Departamenti i Shtetit theksoi se "çdo shkak i mundshëm mbetet spekulativ". Deri më tani nuk është gjetur asnjë provë për një armë të tillë, dhe Kuba dhe Rusia e kanë mohuar se qëndrojnë pas ndonjë sulmi të tillë.

Shumë shkencëtarë mendojnë se teoria e armëve me mikrovalë është e papranueshme. Ndërsa ushtria amerikane ka testuar disa herë pajisje të kontrollit të turmave, të cilat përdorin mikrovalë të fuqishme që mund të udhëtojnë në distanca të gjata, ato janë jashtëzakonisht të mëdha dhe funksionojnë duke e ngrohur lëkurën e njerëzve nga jashtë-brenda; një armë me mikrovalë e aftë të dëmtojë trurin, në fillim do të skuqte mishin e viktimës.

"Ideja që dikush mund të transmetojë sasi të mëdha energjie mikrovalore tek njerëzit dhe të mos jetë e dukshme, bie ndesh me njohurinë e zakonshme që kemi mbi mikrovalët. Sipas kësaj logjike mund të themi se edhe alienët po na godasin me valë elektromagnetike nga planeti Mars" - thotë Kenet Foster, profesor i bioinxhinierisë në Universitetin e Pensilvanisë, që e ka studiuar Efektin Fraj.

Sheril Rojfer, një ish-kimiste në Laboratorin Kombëtar të Los Alamos, ndan një pikëpamje të

ngjashme. "Provat mbi efektet e armës me mikrovalë, të afta të shkaktojnë simptoma si Sindroma e Havanës, janë shumë të dobëta. Asnjë ihtar i kësaj ideje, nuk ka përshkruar se si do të funksiononte në realitet kjo armë.

Deri më tani nuk është ofruar asnjë provë se një armë e tillë, është e zhvilluar nga ndonjë vend. Pretendimet e jashtëzakonshme kërkojnë prova të jashtëzakonshme, dhe asnjë provë nuk na është ofruar për të mbështetur ekzistencën e kësaj arme misterioze" - shkroi Rojfer në "Foreign Policy".

Po nëse nuk është tingulli apo drita, çfarë mund ta ketë shkakuar dëmtimin e trurit që vërehet tek "Sindroma e Havanës"? Shumë ekspertë thonë se "Sindroma e Havanës" është shumë më e mundshme si një sëmundje psikogjenike masive, një dukuri ku njerëzit sëmurën pasi mendojnë se janë ekspozuar ndaj një kërcënimi shëndetësor.

Ekspozimi nuk është i vërtetë, por simptomat - dhe vuajtjet - janë kryesisht rezultat i ndryshimeve në kiminë e trurit dhe lidhjeve nervore, dhe mund të zgjasin me vite. Sëmundje të tilla janë shfaqur ndër shekuj, dhe vazhdojnë të vërehen rregullisht në mbarë botën.

Marrë me shkurtime nga "New York Times" - Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Ulpiana mund Ballkanin, Prishtina Drenicën



PRISHTINË, 31 TETOR - BKT Superliga e Kosovës më nuk ka skuadra të pamposhtura në këtë edicion, pasi Ballkani që nuk kishte pësuar asnjë humbje, është mundur nga Ulpiana në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan me rezultat 2-1. Kjo humbje u ka kushtuar portokallezinjve edhe me humbjen e pozitës së parë, në të cilën pas javës së 12-të ndodhet Drita, skuadër me të cilën do të ballafaqohet Ballkani fundjavën e ardhshme në shtëpi. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me autogolin e Ardi Shalës në minutën e 47 pas harkimit të Armend Thaqit. Vendasit barazuan shifrat në minutën e 70 me golin e Iran Goncalves, teksa fitoren Ulpianës ia siguroi Ardi Shala, kur në kohën shtesë shënoi në portën e duhur. Në ndeshjen tjetër Prishtina iu gëzua fitores së parë në stadiumin "Fadil Vokrri" në këtë edicion, duke e mundur Drenicën me rezultat të

ngushtë 1:0. Golin e fitores për bardhekaltrit e shënoi Besnik Krasniqi në minutën e 82-të. Tri ndeshje të tjera janë zhvilluar të shtunën. Drita ka shënuar fitore në shtëpi në duel me skuadrën e Malishevës, me rezultat 1-0, duke e çuar serinë e saj pozitive në tri fitore radhazi. Deri te fitorja gjilanasit erdhën falë autogolit të Hotit me kokë pas harkimit të Fazliut në minutën e 14-të. Fitore ka shënuar edhe Llapi si mysafir në Drenas në duel me Feronikelin, me rezultat 2-0. Llapjanët realizuan nga një gol në secilën pjesë për tri pikë të rëndësishme nëpërmjet Riveras (38') dhe Valmir Veliut (61'). Ndërkaq, ndeshja ndërmjet Dukagjinit dhe Gjilanit është mbyllur pa fitues, me shifrat 1-1. Të parët në epërsi kaluan vendasit me golin e Ahmed Januzit në minutën e 34-t, por një pikë Gjilanit ia siguroi Gerhard Progni me gjuajtje me kokë në minutën e 86.

BKT Superliga

Ulpiana - Ballkani	2-1
Prishtina - Drenica	1-0
Drita - Malisheva	1-0
Feronikeli - Llapi	0-2
Dukagjini - Gjilani	1-1

Tabela

1. Drita	22 pikë
2. Ballkani	21
3. Gjilani	21
4. Drenica	20
5. Prishtina	16
6. Llapi	15
7. Ulpiana	13
8. Malisheva	12
9. Dukagjini	11
10. Feronikeli	10

SHKURT

Syla fiton të bronzën në kampionatin mesdhetar

Mundësi nga Kosova, Auron Syla, ka rrëmbyer medaljen e bronzit në kampionatin mesdhetar në mundje që është zhvilluar në Xanthi të Greqisë për junior (U20) dhe kadetë. Syla rrethin e parë e kaloi pa luftë teksa fitoren e parë e regjistroi ndaj kundërshtarit nga Shqipëria. Më pas u eliminua nga garuesi grek teksa në luftën përmirësuese për medaljen e bronzit e mposhti mundësin nga Portugalia në kategorinë deri në 86 kilogramë. Në këtë kampionat kanë marrë pjesë mbi 20 shtete me 250 garues. Përveç Auronit, medalje të bronzit fitoi edhe Egzon Xhoni, teksa Kosovën e përfaqësuan edhe Fatlum Braka dhe Bleonit Bytyqi.

Albion Ymeri zuri vendin e tretë në garën ndërkombëtare 'IronMan'

Triatleti i Kosovës, Albion Ymeri, ka zënë vendin e tretë në garën ndërkombëtare "IronMan", grupmosha 25-29, që u mbajt në Antalia të Turqisë, ka bërë me dije Komiteti Olimpik i Kosovës. Koha e tij ishte 3:58.44 orë. Në renditjen e përgjithshme të rezultateve preliminare doli i teti. Në garë morën pjesë 2120 garues nga 83 shtete.

Newcastle mendon për Terryn

Newcastle ende nuk mund të gjejë një trajner për të marrë drejtimin e skuadrës dhe që nga shkarkimi i Steve Bruce, Graeme Jones vazhdon si trajner i përkohshëm. Klubi anglez ka testuar nënshkrimin e Antonio Contes dhe Zidane, por ka hasur në refuzimin e të dyve. Nga klubi kuptojnë se është objektiv prioritar mbyllja e një trajneri të ri dhe vijon të shtojë emra të rinj në listën e objektivave. Sipas asaj që theksojnë nga Anglia, John Terry është një nga emrat që drejtuesit e sportit do të mendonin. Ish-futbollisti i Chelsea është pa skuadër që kur u largua nga posti i tij si ndihmëstrajner në Aston Villa dhe ata do të prisnin me padurim uljen në një stol të Premierë Ligës. Terry sigurisht që do të ishte një opsion i rrezikshëm pasi i mungonte përvoja si trajner, por karriera e tij e gjatë si lojtar do të funksiononte në favor të tij.

Trepça fiton klasiken kundër Prishtinës

MITROVICË, 31 TETOR - Trepça ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 94:72 (23:20, 24:17, 26:16, 21:19), në ndeshjen e mbetur të xhiros së gjashtë të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Pesë minutat e parë të ndeshjes ishin të barabartë deri te rezultati 11:11, kur vendasit hynë në një seri prej 10:0, për 21:11, por më pas rikthehen prishtinasit, ndërsa çereku i parë përfundon 23:20. Periudha e dytë ishte

interesante, ku rezultati ishte i ngushtë dhe tre minuta nga fundi ishte 37:37, megjithatë vendasit hynë sërish në një seri prej 10:0, duke shkuar në pushim me epërsi 47:37. Mitrovicasit nuk u ndalën në periodën e tretë, duke rritur edhe më shumë epërsinë, ku më e larta ishte 73:53, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Në 10 minutat e fundit pamë një lojë ku mitrovicasit ruajtën epërsinë e

krijuar dhe prishtinasit që nuk arritën të bëjnë përmbyesje dhe Trepça triumfoi me rezultat 94:72. Te Trepça u dalluan Drilon Hajrizi me 16 pikë e gjashtë kërcime, Taurus Cockfield Jr me 22 pikë dhe Samir Zekiqi me 17 pikë, kurse te Sigal Prishtina u dalluan Dachon Burke me 16 pikë, Wendell Mitchell dhe Don Poloshka me nga 14 pikë. Trepça ka gjashtë fitore dhe dy humbje, kurse Sigal Prishtina katër fitore dhe katër humbje.



Chicago ia shkakton humbjen e parë Utah Jazzit

CHICAGO, 31 TETOR - Pas katër fitoresh, Utah Jazz pësoi humbjen e parë sezonale në NBA pasi u mposht nga Chicago Bulls me rezultatin 107-99. Për

skuadrën nga Illinois kjo ishte fitorja e pestë në gjashtë takime falë dyshes DeMare De Rozan, autor i 32 pikëve dhe Zac Lavine që shtoi 26 të tjera. Një sukses të

thjeshtë arriti edhe Miami Heat në transfertën përballë Memphis Grizzliesin me rezultatin 129-103 për meritë të Jimmy Butlerit, autor i 27

pikëve, ndërkohë që surprizën e bëri San Antonio Spursi që triumfoi në transfertën ndaj Milwaukee Bucksit me shifrat 102-93.



Kampionia nuk ndalet, shënon fitore të thellë ndaj Kastriotit

PRISHTIN, 31 TETOR - Penza ka regjistruar fitoren e katërt në katër ndeshje në Superligën e Femrave, duke mundur Kastriotin me rezultat 16:131, ndërkohë që për skuadrën ferizajase ishte humbja e katërt. Kampionet dominuan nga fillimi deri në fund për të shënuar fitore të merituar. Te Penza u dalluan pesë basketbolliste: Rael Whitsitt me 34 pikë e 17 kërcime, Jeta Zeka me 20 pikë e 12 kërcime, Diedona Halitaj me 23 pikë e 15 asistime, Vanesa Bojku me 16 pikë dhe 11 topa të vjedhur dhe Ermelinda Gjukaj me 24 pikë e 13 kërcime. Vëllaznimi ka mundur Trepçën në udhëtim 42:70, ku tri periodat e parë ishin të barabarta, por në atë të fundit u bë dallimi 4:32. Te skuadra kuqezi u dalluan Viola Tanushi me 14 e 12 kërcime,



Anila Selmani me 11 pikë e 15 kërcime dhe Rina Hoda me 19 pikë. Tashmë të dyja skuadrat kanë nga një fitore dhe tri humbje. Të premtën mbrëma është zhvilluar derbi i javës

ndërmjet Prishtinës dhe Bashkimit, ku fituan vashat prishtinase 77:61, duke regjistruar fitoren e katërt, kurse vashat prizrenase kanë dy fitore dhe dy humbje.

Rahoveci pëson humbje nga Teuta në Ligën Unike

RAHOVEC, 31 TETOR - Teuta ka shënuar fitore ndaj Rahovecit në udhëtim me rezultat 103:123 (26:21, 24:37, 26:39, 27:26), në javën e dytë të Ligës Unike. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, por vendasit në minutat e fundit të çerekut të parë krijuan epërsi prej tetë pikësh, 22:14, kurse kjo pjesë përfundoi me shifrat 26:21. Megjithatë, mysafirët u kundërpërgjigjën shpejt, për të barazuar shifrën në 29:29, e më pas ishin në epërsi të lehtë, kurse në fund të pjesës së parë u shkëputën në 50:58, sa përfundoi pjesa e parë. Skuadra durrsake vazhdoi lojën e mirë në periodën e tretë, ndërsa Vreshtarët nuk kishin përgjigje për lojën e tyre. Me kalimin e minutave epërsia sa vinte e shtoej, kurse më e larta ishte 74:97, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte



76:97. Në 10 minutat e fundit Teuta menaxhoi epërsinë, kurse Rahoveci nuk arriti të bëjë më shumë dhe ndeshjen e përfundoi me fitoren e Teutës 103:123. Te Rahoveci u dalluan Altin Morina me 25 pikë, pesë

kërcime dhe dhjetë asistime, kurse te Teuta më i miri në parket ishte Cameron Saterwhite me 30 pikë e nëntë kërcime. Rahoveci ka dy humbje, kurse Teuta një fitore dhe një humbje.

SHKURT

Aguero diagnostikohet me aritmi të zemrës

Mediumi i njohur spanjoll, "Sport", njofton se Sergio Agüero është diagnostikuar me aritmi të zemrës. Sulmuesi argjentinas u zëvendësua në pjesën e parë të ndeshjes së djeshme ndaj Alaves. Ai u rrëzua në tokë, ndërsa iu dha edhe ndihma në fushë, para se të dërgohej në spital për ekzaminime të mëtejme. Aty iu nënshtrua disa studimeve të kardiologjisë për shkak të shqetësimit në gjoks dhe u diagnostikua me një aritmi kardiake, domethënë një çrregullim të ritmit të zemrës. Agüero do t'i nënshtrohet edhe disa testeve të tjera për ta kuptuar më hollësisht gjendjen e tij shëndetësore. Para pak orëve, Barcelona njoftoi edhe për lëndimin e Gerard Pique, i cili nuk do të jetë në dispozicion deri pas pushimit ndërkombëtar.

O'Neal: Fëmijëve gjithë kohën ju them se ne nuk jemi të pasur

Basketbollisti legjendar Shaquille O'Neal ka një pasuri rreth 400 milionë dollarë. Ai është baba i gjashtë fëmijëve, por edhe pse se është multimilioner, nuk u jep fëmijëve para në shuma të mëdha. Në një intervistë për "Earn Your Leisure", Shaq ka thënë: "Fëmijët e mi janë të rritur tash. Ata janë disa të nervozuar me mua, nuk mund të më kuptojnë, pasi gjatë tërë kohës ju them. 'Ne nuk jemi të pasur, unë jam i pasur'. Nëse ke diplomë të bachelorit apo masterit dhe dëshiron që unë të investoj në një nga kompanitë e juaja, ju duhet të ma prezantoni dhe unë do ta shikoj. Unë nuk ju jap asgjë falas. Për mua është një rregull: Edukimi. Nuk më intereson nëse luani basketboll, nuk më intereson fare".

Pogba dëshiron të rikthehet në Juventus

Paul Pogba është lojtari i shumë përfolur këtë sezon te skuadra e Manchester Unitedit. Francezi nuk ka pranuar ta rinovojë kontratën me "djajtë", sepse dëshiron një transferim te një skuadër tjetër gjatë sezonit të ardhshëm. Sipas asaj që raporton "Footballitalia", Pogba tashmë e ka zgjedhur skuadrën se ku do të luajë vitin e ardhshëm. Italia është destinacioni i tij i pëlqyer, që e shikon Torinon si një mundësi shumë të mirë ku mund të fitojë me skuadrën e Juventusit. Një rikthim te Juve mund të bëhet me parametra zero, sepse kontrata aktuale e Pogbas me Unitedin mbaron në fund të qershorit të ardhshëm. "Bardhezinjtë" mund t'i ofrojnë francezit një pagë prej 12 milionë eurosh në sezon plus bonuse. Dritare të tjera për Pogban nëse nuk arrihet marrëveshja e duhur me skuadrën italiane, është edhe Real Madridi dhe PSG-ja që duan shërbimet e 28-vjeçarit.

Contes nuk i interesohen oferta e Tottenhamit

Antonio Conte po lidhet me një kalim te Tottenham Hotspuri derisa Nuno Espirito Santo mund të shkarkohet. Trajneri italian është aktualisht i papunë që kur u largua nga Interi si kampion dhe tani po kërkon një aventurë të re. Por, sipas asaj që raporton "Calciomercato", Conte nuk e pëlqen kalimin te Spursi, pasi e di se klubi nuk investon në prurje të reja. Strategu italian tashmë është i njohur për Ligën Premierë pasi kishte shkëlqyer te Chelsea qysh në edicionin e parë. Ai lidhet po ashtu me kalimin te Manchester Unitedi, mirëpo ende nuk ka ndonjë kontakt mes të dyja palëve. Conte e pëlqen kalimin te "Djajtë e Kuq" dhe për këtë, sipas mediave në Itali, ai po refuzon kalimin te Tottenhami.

Ibra: Nuk mund të habitem nëse jam më i miri

Zlatan Ibrahimoviç ka thënë se Milani mund të mos jetë klubi i tij i fundit, megjithëse 40-vjeçari beson në "Scudetto". 40-vjeçari foli për "Telefoot" në Francë për karrierën e tij të gjatë,

veçanërisht pasi ka hyrë së fundmi në dekadën e tij të pestë. "Sekreti i jetëgjatësisë sime është në mendje, pasi po përpiqem të dëshmoj se 40 është vetëm një numër dhe mund të vazhdoj të bëj

atë që dua. Dua të vazhdoj të përmirësohem çdo ditë. Natyrisht, nuk mund të luaj siç luaja më parë, por tani jam më inteligjent dhe kam më shumë përvojë", ka thënë Ibrahimoviç.

Natyrisht, atij iu desh pak kohë për të luajtur me personalitetin e tij të zakonshëm arrogant që e ka shoqëruar për caq shumë vite, shkruan "footballitalia". "Nuk jam i befasuar nga

paraqitjet e mia, jam më i miri. Nuk mund të habitem nëse jam më i miri. Përpiqem t'i ndihmoj shokët e skuadrës që të përmirësohen", ka shtuar Ibra.

32 vite pa më të dashurin tonë



Bedri (Ilaz) Sokoli

Me rastin e 32 vjetorit të rënies të dëshmorit Bedri (Ilaz) Sokoli, ju njoftojmë të gjithë farefisnin, shokët se me datë 01.11.2021 në ora 13:00 mbahen homazhe përkujtimore në kompleksin e dëshmorëve në Penuh!

Të përkujtojnë me mall: djali Graniti me familje dhe gjithë familja Sokoli.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

